



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.09.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Roza Komani B.I lidhur me aktivitetin e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, nxjerr:


V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Roza Komani B.I, e dt.29.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 25.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:25.09.2025;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .



Arsyetim

Operatori Ekonomik Roza Komani B.I, me dt.29.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Re-Tender-II-të-Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-5966-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1, Grupi i OE në pikën 5.2 faqe 1 kanë prezantuar Defrim Kabashi Master i shkencave teknike të ndërtimarisë departamenti Konstruktiv, Infrastruktura rrugore ku data e diplomimit është 7 Mars 2022 gjë që nuk e plotëson kushtin siq është kërkuar në DT me 5 vite provoj pune pas diplomimit

Sqarim:

- Grupi i OE kanë prezantuar Defrim Kabashi – Master i shkencave teknike të ndërtimarisë departamenti Konstruktiv, Infrastruktura rrugore. Kandidati i ka kryer studimet më datë 23.07.2015 që e plotëson kërkesën.
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 2, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose profesionale 9.1&9.2, pika f)

f) Kërkesa: Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve - IPMA.

Dëshmia: Licencat përkatëse e lëshuar nga subjektet e licencuar,

Sqarim : Bazuar në kërkesën dhe dëshminë:

- Ju keni prezantuar Certifikatë pjesëmarrje në trajnim 15 ditor për Menaxhimin e projekteve të lëshuar nga projekti Kosvet IV dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Kjo nuk është certifikatë IPMA dhe as Licencë e lëshuar nga një subjekt i licencuar nga IPMA.
- Licenca duhet të jetë zyrtare e njohur nga IPMA, me logon e tyre dhe e cila lëshohet nga një subjekt i autorizuar. Në dokument duhet të shënohet niveli i certifikimit dhe data e vlefshmërisë.
- **Ky dokument nuk mund të pranohet sepse nuk është certifikim i licencuar IPMA i kërkuar në dosje.**

Pretendimi 3, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve- Pika 2 : Dumper me peshë nga 2 deri në 5 ton, me certifikata të regjistrimit të automjetit me afat valid. (2 copë)

Sqarim:

Në Dosjen e tenderit pika 9. Makineria Triangle, fleta 1 OE ka prezantuar Aneksi 7 . Lista e Pajisjeve – Tabelën me të dhënat e kërkuara dhe te Kolona "Të dhënat për pajisje" ka prezantuar:

- 2014, gjendje e mire,06-564-GB, makine e punës veteshkarkuese, marreveshje "EL BAU" shih file.
- 2006, gjendje e mire, 06-630-GM, makine e punes, marreveshje "ECO HOLDING", shih file,

Makinat e prezentuara plotësojnë kushtet sikur janë kërkuar,

- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 4, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve- Pika 10 : makina me vibrim për beton (2 copë)

Sqarim:

- Në Dosjen e tenderit pika 9. Makineria Triangle, fleta 1 OE ka prezantuar Aneksi 7 . Lista e Pajisjeve – Tabelën me të dhënat e kërkuara dhe te Kolona “Të dhënat për pajisje” ka prezantuar: dy makina me vibrim për beton. OE ka plotësuar kushtin.
- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Pretendimi 5, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve- Pika 11 : makina me pllaka vibruese – rrafshuese (2 copë)

Sqarim:

Në Dosjen e tenderit pika 9. Makineria Triangle, fleta 1 OE ka prezantuar Aneksi 7 . Lista e Pajisjeve – Tabelën me të dhënat e kërkuara dhe te Kolona “Të dhënat për pajisje” ka prezantuar:

- 2015, gjendje e mire, Marka- Wacker Neuson, makina ngjeshese te rrugeve, marreveshja GLOBI, shih dudin - Makine ngjeshese e rrugëve
- Makine me pllaka vibruese, shih dudin , marreveshje EL-BAU,

Sqarim: OE makinen me pllaka vibruese per beton, me marreveshje EL-BAU e ka prezantuar – Makine ngjeshese e rrugëve

- **Pretendimi i juaj nuk qëndron.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;